

AKTI I THEMELIMIT

I SHOQERISE "RIVIERA"shpk.



Neni 1

Me vullnetin e lire te ortakut te vetem DRITAN ÇELA, lindur me 1968 ne Vlore dhe banues ne Vlore, Lagja "28 Nentori", Sheshi i Flamurit, themelohet shoqeria tregetare private me emrin "RIVIERA"sh.p.k.

Neni 2

Shoqeria do t'a kete qendren e saj ne qytetin e Vlores, por sipas parashikimeve ne statut, aparati administrativ mund te ngraje qendra te dyta ose filjale edhe ne vende te tjera.

Neni 3

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise do te jete per 20 vjet, por sipas parashikimeve ne statut shoqeria mund te zgjase afatin minimal te veprimtarise se saj ose mund te shkrihet perpara ketij afati.

Neni 4

Shoqeria do te kete per objekt te veprimtarise se saj :

-Veprimtari ne fushen e ndertimeve industriale dhe civile, prodhimin dhe shitjen e materialeve te ndertimit si dhe te artikujve te tjere industriale dhe ushqimore, brenda dhe jashte vendit per eksport dhe import.

-Veprimtari ne fushen e sherbimeve, informacionit industriale dhe tregetar.

-Veprimtari ne fushen e transportit.

Neni 5

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100000 leke. Eshte teresisht kapital financiar dhe i depozituar ne banke ne emer te shoqerise "RIVIERA"sh.p.k.

Kapitali themeltar eshte i ndare ne 100 kuota me vlere 1000 leke sejcila kuote.

I tere kapitali themeltar zoterohet nga ortaku i vetem Dritan Çela i cili ka te drejte te shtoje kuotat e ketij kapitali, apo t'i tjetërsoje ato tek persona te trete, sipas parashikimeve ne statut.

Neni 6

Organi i vetem administrativ i shoqerise "RIVIERA"sh.p.k. eshte

administratori i vetem.Kompetencat e tij jane te percaktuara ne statut.

Neni 7

Meqenese veprimtaria e shoqerise "RIVIERA"sh.p.k. do te bazohet ne statutin e saj,Ligjin Nr.7638,date 19.11.1992"Per shoqerite tregetare" si dhe legjislacionin ne pergjithsi te Republikes se Shqiperise.

Neni 8

Ky akt themelimi u nenshkrua sot me date 3.7 1995.

ORTAKU I VETEM

Orifan Cela

REPUBLICA E SHQIPERISE
NOTERIA VLORE

Nr. 2703 repertorit
Vlore, me 3.7 1995

VERTETIM


Me ane te te cilit vertetojme se ortakut i vetem i shoqerise "RIVIERA" sh.p.k.,e nenshkroi aktin e themelimit te shoqerise me vullnetin e tij te lire dhe ne pranine time.Pas kesaj une noterja e vertetova dhe e rregjistrova

NOTERJA

ALMA MUSARAJ

S T A T U T I

I SHOQERISE "RIVIERA"sh.p.k.



Neni 1

Eshte themeluar nje shoqeri tregtare private me pergjegjesi te kufizuar, me emrin "RIVIERA"sh.p.k.

Neni 2

Qendra e shoqerise eshte ne qytetin e Vlores, lagja "28 Nentori" "N". Aparati administrativ, me vendim te ortakut te vetem mund te ndertoje qendra te dyta ose filjale ne vende te tjera.

Neni 3

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte caktuar per 20 vjet, por me vendim te ortakut te vetem ky afat mund te zgjatet ose shoqeria mund te shkrihet para kohe sipas parashikimeve ne kete statut.

Neni 4

Shoqeria do te kete per objekt te veprimtarise se saj:

-Veprimtari ne fushen e ndertimeve industriale dhe civile, prodhimin dhe shitjen e materialeve te ndertimit si dhe te artikujve te tjere industriale dhe ushqimore, brenda dhe jashte vendit, per eksport dhe import.

-Veprimtari ne fushen e sherbimeve, informacionit industrial e tregetar, si dhe veprimtari ne fushen e transportit.

Neni 5

Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga 100.000 leke. Eshte teresisht kapital financiar dhe i depozituar ne banke ne emer te shoqerise "RIVIERA"sh.p.k.

Kapitali themeltar eshte i ndare ne 100 kuota me vlefte 1.000 leke sejcila kuote.


I gjithë kapitali themeltar i shoqerise zoterohet nga ortaku i vetem

Dritan Çela i cili ka te drejte te tjetersoje kete kapital, te shtoje apo pakesoje kuotat e kapitalit deri ne kufijte minimal qe percakton ligja.

Neni 6

Organi i vetem administrativ i shoqerise "RIVIERA"shpk., eshte administratori i vetem i saj.

Neni 7

 Ortaku i vetem dhe administratori i shoqerise eshte perfaqesuesi i vetem i shoqerise. Ai perfaqeson shoqerine ne mardhenie me te tretet, nenshkruar ne emer te saj te gjitha aktet qe kane te bejne me veprimtarine e shoqerise, ka te drejten e perfaqesimit gjyqesor dhe eshte firme e vetme e shoqerise ne banke.

Neni 8

Kompetencat administrative te administratorit te shoqerise, barazohen me kompetencat qe me ligj i takojne asamblese se ortakeve.

Administratori dhe ortakut i vetem miraton statutin dhe ndryshimet ne t.

Miraton bilancet

Zgjedh keshillin administrativ.

Vendos per ndarjen e te ardhurave, pjesmarjen ne shoqeri te tjera, shkrirjen e shoqerise para kohe, zgjatjen e afatit minimal te veprimtarise se shoqerise, hapjen e filjaleve te shoqerise ne vende te tjera si dhe per çeshtje te tjera qe me ligj i takojne asamblese se ortakeve dhe administratorit.

Neni 9

Ortaku i vetem dhe administratori i shoqerise mund te perfaqesohet nga persona te trete te besuar prej tij, gjithmone brenda kufijve ligjore dhe me prokure te leshuar sipas ligjit.

Funksionet administrative te jashtezakoneshme nuk mund te transferohen

Neni 10

Veprimtaria vjetore e shoqerise mbyllet ne 31 Dhjetor te çdo viti.

Neni 11

Ne perfundim te mbylljes se bilancit ortakut i vetem percakton menyren e shperndarjes se fitimit, likuidimin e detyrimeve dhe percaktimin e rezervave ligjore. Si rregull rezerva ligjore nuk mund te jete me e vogel se 5 per qind e fitimit te realizuar.

Neni 12

Me mbarimin e afatit te caktuar shoqeria shperndahet dhe ortakut i



vetem do të caktoje një ose disa likuidatore, të cilët, në bazë të ligjit do të realizojnë shkrirjen e shoqërisë.

Neni 13

Shoqëria mund të shkrirhet para kohë:

1. Me vendim të ortakut të vetëm.
2. Pas dy vjeteve me bilanc negativ.

Neni 14

E gjithë veprimtaria e shoqërisë "RIVIERA" shpk., do të bazohet në Ligjin Nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregëtare", si dhe legjislacionin në përgjithësi të Republikës së Shqipërisë.

Neni 15

Shoqëria "RIVIERA" shpk., do të ketë vullnetin e saj.

Ky statut u nënshkrua sot me datë 3.7 1995.

ORTAKU I VETEM

DRITAN ÇELA



REPUBLICA E SHQIPERISE

NOTERIA VLORE

Nr. 1709 repertorit

Vlore, me 3.7 1995

V E R I E T I M

Me anë të të cilit vertetoj se ortakut i vetëm i shoqërisë "RIVIERA" sh.p.k., e nënshkroi statutin e shoqërisë me vullnetin e tij të lire dhe në praninë time. Pas kësaj une noterja e vertetova dhe e rregjistrova.

N O T E R J A

ALMA MUSARAJ